REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

KRYETARI I BASHKISË

Nr. 2829 Prot Maliq, më 23.5.2025

PROJEKT-VENDIM - NR. 10

Për

Nxjerrjen nga përdorimi dhe heqjen nga regjistri i aktiveve, të disa prej objekteve të transferuara nga Ministria e Mjedisit me Aktin e Transferimit nr. 2546 prot., datë 15.05.2017

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 "*Për Vetëqeverisjen Vendore*" i ndryshuar, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.2, shkronja "a" dhe "c", dhe nenit 54, Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" i ndryshuar, Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktivëve në njësitë e sektorit publik*" i ndryshuar, Kreut IV, pika 103, 118 dhe 120, Aktit të Transferimit nr. 2548 prot., datë 15.05.2017, Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë nr. 181, datë 03.04.2025 "*Për ngritjen e komisionit për verifikimin dhe vlerësimin e aktiveve të transferuara nga Ministria e Mjedisit me Aktin e Transferimit nr. 2548 prot., datë 15.05.2017*", si dhe proces-verbalet e mbajtur nga komisioni i verifikimit dhe vlerësimit,

PROPOZOJMË:

1. Nxjerrjen nga përdorimi dhe heqjen nga regjistri i aktiveve, të disa prej objekteve të transferuara nga Ministria e Mjedisit me Aktin e Transferimit nr. 2546 prot., datë 15.05.2017, të pasqyruara në tabelën si më poshtë:

Nr.	Nr. sipas listës në aktin e transferimit	Vendndodhja/Zona Kadastrale	Emërtimi i objektit	Gjendja aktuale e objektit	Lloji i ndryshimit të miratuar
1	1	Plasë, ZK 2984	Sekt 1 kat Plasë	I shembur, nuk ekziston	Të hiqet nga lista e aktiveve
2	2	Moglicë, ZK 2710	Stacion 1 kat Moglicë	I amortizuar, gati në rrënim	Të nxirret nga përdorimi dhe hiqet nga lista e aktiveve
3	3	Ek. Pyjore Bofje, Moglicë	Fjetore Bofje	I shembur, rrënoja	Të hiqet nga lista e aktiveve

2. Ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, si dhe Drejtoria e Pronave Publike dhe Aseteve pranë Bashkisë Maliq për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas percaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr. 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*", i ndryshuar.

KRYETARI I BASHKISË

Gëzim Topçiu

Konceptoi: N. Çaushi Dt. 21/05/2025

Drejtor D.P.P.A: J. Sulo Dt. 21/05/2025

Adresa: Bulevardi "Rinia" Maliq, Korçë Tel. & Fax. 0861 2 2026 www.bashkiamaliq.gov.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

KRYETARI I BASHKISË

Nr. 2829 Prot Maliq, më 23. 5 .2025

Lënda: Relacion shpjegues mbi Projekt-Vendimin *"Për nxjerrjen nga përdorimi dhe heqjen nga regjistri i aktiveve, të disa prej objekteve të transferuara nga Ministria e Mjedisit me Aktin e Transferimit nr. 2546 prot., datë 15.05.2017"*

Drejtuar: **Këshillit të Bashkisë Maliq**

Të nderuar Këshilltarë,

Projekt-Vendimi *"Për nxjerrjen nga përdorimi dhe heqjen nga regjistri i aktiveve, të disa prej objekteve të transferuara nga Ministria e Mjedisit me Aktin e Transferimit nr. 2546 prot., datë 15.05.2017"*, mbështetet në Ligjin nr. 139/2015 *"Për Vetëqeverisjen Vendore"* i ndryshuar, nenin 8, pika 2, nenin 9, pika 1, nënpika 1.2, shkronja "a" dhe "c", dhe nenin 54, Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"* i ndryshuar, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 *"Për menaxhimin e aktivëve në njësitë e sektorit publik"* i ndryshuar, Kreut IV, pika 103, 118 dhe 120, Aktin e Transferimit nr. 2548 prot., datë 15.05.2017, Urdhërin e Kryetarit të Bashkisë nr. 181, datë 03.04.2025 *"Për ngritjen e komisionit për verifikimin dhe vlerësimin e aktiveve të transferuara nga Ministria e Mjedisit me Aktin e Transferimit nr. 2548 prot., datë 15.05.2017"*, si dhe proces-verbalet e mbajtur nga komisioni i verifikimit dhe vlerësimit.

Në zbatim të Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 *"Për menaxhimin e aktivëve në njësitë e sektorit publik"* i ndryshuar, Kryetari i Bashkisë me Urdhër nr. 181, datë 03.04.2025 *"Për ngritjen e komisionit për verifikimin dhe vlerësimin e aktiveve të transferuara nga Ministria e Mjedisit me Aktin e Transferimit nr. 2548 prot., datë 15.05.2017"*, ka ngritur komisionin e verifikimit dhe vlerësimit të aktiveve të transferuara nga Ministria e Mjedisit me Aktin e Transferimit nr. 2548 prot., datë 15.05.2017. Detyra e komisionit ka qënë të verifikojë në terren aktivet e transferuara sipas aktit të transferimit të mësipërm, dhe të bejë vlerësimin fizik të gjendjes së tyre, sipas kritereve të vlerësimit të përcaktuara në pikën 103 të udhëzimit.

Bazuar në proces-verbalet e mbajtur nga komisioni, për 3 (tre) objekte, gjendja ka rezultuar si më poshtë:

Në proces-verbalin e datës 10.04.2025, të mbajtur nga komisioni mbi kontrollin e ushtruar në objektin "Sekt 1 kat Plasë" i ish Ndërmarrjes së Pyjores Korçë, pasqyrohet se: objekti është

shembur dhe nuk ekziston. Në afërsi të objektit të shembur është ngritur ndërtim i ri, i cili posedohet nga z. Gëzim Skerma, e paraqitur kjo dhe nëpërmjet fotove të mbajtura nga komisioni në vendin ku ka qënë objekti, të cilat gjenden bashkëlidhur proces-verbalit. Për sa më sipër, komisioni bazuar në kriteret e vlerësimit, shkronja "f" dhe "h", të pikës 103 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, për këtë objekt, konkludon se: objekti ka humbur cilësitë e tij të caktuara në standartet shtetërore, dhe si pasojë e shëmbjes dhe ndryshimeve teknike ka humbur misionin e njësisë, dhe mundësinë e përdorimit për qëllimin e caktuar fillestar.

Në proces-verbalin e datës 14.04.2025, të mbajtur nga komisioni mbi kontrollin e ushtruar në objektin "Stacion 1 kat Moglicë" i ish Ndërmarrjes së Pyjores Korçë, pasqyrohet se: objekti është në gjendje tejet të amortizuar dhe gati në rrënim, e paraqitur kjo dhe nëpërmjet fotove të mbajtura nga komisioni, të cilat gjenden bashkëlidhur proces-verbalit. Për sa më sipër, komisioni bazuar në kriteret e vlerësimit, shkronja "b", "d", "f", "g" dhe "h", të pikës 103 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, për këtë objekt, konkludon se: objekti ka humbur cilësitë e tij të caktuara në standartet shtetërore, dhe si pasojë e amortizimit dhe ndryshimeve teknike ka humbur misionin e njësisë, dhe mundësinë e përdorimit për qëllimin e caktuar fillestar.

Në proces-verbalin e datës 14.04.2025, të mbajtur nga komisioni mbi kontrollin e ushtruar në objektin "Fjetore Bofje" i ish Ndërmarrjes së Pyjores Korçë, pasqyrohet se: objekti është shembur dhe në të kanë ngelur vetëm rrënoja, e paraqitur kjo dhe nëpërmjet fotove të mbajtura nga komisioni, të cilat gjenden bashkëlidhur proces-verbalit. Për sa më sipër, komisioni bazuar në kriteret e vlerësimit, shkronja "f" dhe "h", të pikës 103 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, për këtë objekt, konkludon se: objekti ka humbur cilësitë e tij të caktuara në standartet shtetërore, dhe si pasojë e shëmbjes dhe ndryshimeve teknike ka humbur misionin e njësisë, dhe mundësinë e përdorimit për qëllimin e caktuar fillestar.

Ndodhur në kushtet kur këto objekte janë jashtë funksionit, ku dy prej tyre janë të shembura dhe nuk ekzistojnë më ("Sekt 1 kat Plasë" dhe "Fjetore Bofje") dhe "Stacion 1 kat Moglicë" është në gjëndje tejet të amortizuar dhe gati në shembje, në mbështetje të Kreut IV, pika 103 dhe 118 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktivëve në njësitë e sektorit publik*" i ndryshuar, propozojmë nxjerrjen nga përdorimi të tyre dhe heqjen nga lista e aktiveve.

Për sa më sipër në kompetencën Tuaj, kërkojmë miratimin e këtij projekt-vendimi.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin Tuaj!

Konceptoi: N. Çaushi Dt. 21 / 05 /2025

Drejtor D.P.P.A: J. Sulo Dt. 21 / 05 /2025

KRYETARI I BASHKISË

Gëzim Topçiu

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

KRYETARI I BASHKISË

Nr. 2026 Prot Maliq, më 03.04.2025

URDHËR

Nr. 181, datë 03.04.2025

PËR

NGRITJEN E KOMISIONIT PËR VERIFIKIMIN DHE VLERËSIMIN E AKTIVEVE TË TRANSFERUARA NGA MINISTRIA E MJEDISIT ME AKTIN E TRANSERIMIT NR. 2548 PROT., DATË 15.05.2017

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*" i ndryshuar, neni 64, gërma "a", Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" i ndryshuar, Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktivëve në njësitë e sektorit publik*" i ndryshuar, Kreu IV, pikat 96, 98, 99, 103 dhe 104, Aktit të Transferimit nr. 2548 prot., datë 15.05.2017,

URDHËROJ:

1. Ngritjen e komisionit për verifikimin dhe vlerësimin e aktiveve të transferuara me Aktin e Transferimit nr. 2548 prot., datë 15.05.2017, me përbërje si më poshtë:
   - Klarsen Brako – Përgjegjës/Sektori i Pyje-Kullota
   - Petrika Theodhosi – Ing. Specialist/Sektori i Pyje-Kullota
   - Fjoralda Demollari – Përgjegjës/Sektori i Menaxhimit të Aktiveve
   - Mevlan Lame – Topograf/Sektori i Pronave Publike dhe Aseteve
   - Administratori i Njësisë Administrative respektive
2. Komisioni ka për detyrë të verifikojë në terren aktivet e transferuara nga Ministria e Mjedisit me Aktin e Transferimit nr. 2548 prot., datë 15.05.2017, dhe të bëjë vlerësimin fizik të tyre, sipas kritereve të vlerësimit të përcaktuara në pikat 103 dhe 104 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011.
3. Në përfundim të procesit komisioni të mbajë proces-verbalin e vlerësimit.
4. Për zbatimin e këtij urdhëri ngarkohet komisioni i ngritur në pikën 1.
5. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I BASHKISË

Gëzim Topçiu

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MALIQ

REPUBLIKA E SHQIPERISE

Per Ministrine e Mjedisit — **Per Bashkine Maliq**

Nr 3611 Prot Dt 2.5.2017 — Nr 2548 Prot Dt 15.05.2017

AKT TRANSFERIMI

Ne zbatim te **VKM Nr. 433, datë 8.6.2016** "PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË BASHKIVE TË PYJEVE DHE TË KULLOTAVE PUBLIKE, SIPAS LISTAVE TË INVENTARIT, DHE AKTUALISHT NË ADMINISTRIM TË MINISTRISË SË MJEDISIT E TË ISH- KOMUNAVE/ BASHKIVE" pika 36 , të Ligjit nr.10 296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" dhe Udhezimit Nr.30, datë 27.12.2011"PËR MENAXHIMIN E AKTIVEVE NË NJËSITË E SEKTORIT PUBLIK" neni 108 po ju transferojme inventarin e Godinave ne administrim te territorit te kesaj bashkije sipas listes :

Nr	Emertimi	Vlera e mbetur
1	Sekt 1 kat Plase	20,100
2	Stacion 1 kat Moglice	18,665
3	Fjetore Bofje	317,658
4	Stac 1 kat Mag	33,220
5	Stac 1 kat Lozhan	1,337,891
		1,727,534

Sektoret e Finances e te dy institucioneve te kryejne veprimet financiare reciproke per pasqyrimin ne kontabilitet te ketij transferimi .

Per Ministrine e Mjedisit

Alqi BELLAKO

Sekretar I Pergjithshem

Per Bashkine Maliq

Kryetar

REPUBLIKA E SHQIPERISE BASHKIA MALIQ

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
KOMISIONI
Nr. 181, datë 03.04.2025

Maliq, më 10.04.2025

PROCES-VERBAL

"Mbi verifikimin dhe vlerësimin e objektit me emërtimin "Sekt 1 kat Plasë", të transferuar nga Ministria e Mjedisit me Aktin e Transferimit nr. 2548 prot., datë 15.05.2017"

Në mbështetje të pikave 104 dhe 105 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*" i ndryshuar, mbahet ky proces-verbal nga komisioni i ngritur me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë Nr. 181, datë 03.04.2025 "*Për ngritjen komisionit për verifikimin dhe vlerësimin e aktiveve të transferuara nga Ministria e Mjedisit me Aktin e Transferimit nr. 2548 prot., datë 15.05.2017*", mbi verifikimin dhe vlerësimin e kryer në datën 07.04.2025, në objektin me emërtimin "Sekt 1 kat Plasë", të transferuar nga Ministria e Mjedisit me Aktin e Transferimit nr. 2548 prot., datë 15.05.2017.

Në Aktin e Transferimit nr. 2548 prot., datë 15.05.2017, me numër rendor 1 në listë, Ministria e Mjedisit ka transferuar pranë Bashkisë Maliq, godinën me emërtimin "Sekt 1 kat Plasë", me vlerë kontabël 20,100 (*njëzetë mijë e njëqind*) lekë.

Nga verifikimi i kryer nga komisioni në terren, rezultoi se:

Objekti "Sekt 1 kat Plasë" i ish Ndërmarrjes së Pyjores Korçë, është shembur dhe nuk ekziston. Në afërsi të objektit të shembur është ngritur ndërtim i ri, i cili posedohet nga z. Gëzim Skerma, kjo e pasqyruar dhe me fotot e mbajtura nga komisioni në vendin ku ka qënë objekti, të cilat i bashkëlidhen këtij proces-verbali.

Për sa më sipër, komisioni bazuar në kriteret e vlerësimit, shkronja "f" dhe "h", të pikës 103 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, konkludon se:

Objekti ka humbur cilësitë e tij të caktuara në standartet shtetërore, dhe si pasojë e shëmbjes dhe ndryshimeve teknike ka humbur misionin e njësisë, dhe mundësinë e përdorimit për qëllimin e caktuar fillestar.

Mbahet ky proces-verbal në 3 (tre) kopje.

KOMISIONI:

Klarsen Brako	Petrika Theodhosi	Fjoralda Demollari	Mevlan Lame	Kreshnik Azo

